

**I. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Inxhinierisë Informatike shpall 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë, në kategorinë asistent-lektor në fushën e Inxhinierisë Informatike që të mbulojë lëndët si më poshtë;**

Në diplomën, *Bachelor në Inxhinieri Informatike*, FTI

- *Rrjetat e kompjuterave;*
- *Strukturë të dhënash.*

Në ciklin e dytë Master Profesional në Inxhinieri Informatike:

- Sisteme operative dhe rrjetat (laboratore dhe detyra).

**Kandidati duhet të plotësojë këto kritere:**

1. Të ketë mbaruar studimet në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit ose Universitete të huaja, në sistemin 5 (pesë) vjeçar ose në sistemin e studimeve 3+2 (Bachelor + Master Shkencor) në fushën e Inxhinierisë Informatike;
2. Nota mesatare e studimeve universitare (për studimet 5-vjeçare), e barabartë ose më e lartë se 9.00; për sistemin 3+2 Bachelor të jetë  $\geq 8.5$  dhe Master i Shkencave të jetë  $\geq 9.00$ ;
3. Të ketë dëshminë/certifikatën e mbrojtjes së gjuhës së huaj, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në nivelin C1. Preferohet gjuha angleze;
4. Të ketë artikuj të botuar në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe kod ISSN si dhe Referime Shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings, me kod ISBN. Artikujt dhe referimet shkencore do të vlerësohen si të tilla vetëm në rast të lidhjes së tyre me fushën e Inxhinierisë Informatike, si tregues për fushën e ardhshme kërkimore – shkencore të kandidatit;
5. Të ketë të paktën 3 (tre) vite eksperiencë pune në mësimdhënie në universitet;
6. Dy rekomandime nga staf akademik i FTI, UPT ose i Fakultetit/Universitetit përkatës ku kandidati ka kryer studimet, me titull Profesor ose Profesor i Asociuar, me datë jo më të hershme se data e daljes së njoftimit përkatës të punësimit, specifikisht të cilësuar për personel akademik me kohë të plotë në DII, FTI.

**II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **14.05.2021** pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Rektoratit e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e sipërcituar.

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuar; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë ose “DOKTOR” të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.